

Në 95-vjetorin e lindjes

Aleksandër Moisiu në skenat e botës

Vangjel Moisiu,

bashkëpunëtor i vjetër shkencor

- Unë jam rritur në Shqipëri... babai im është shqiptar dhe nëna ime është shqiptare nga arbëreshët...
- Ja tek qendronte një aktor i madh dhe i famshëm.
- ...Një zë malli, dhëmbjeje, gëzimi, dhe, mbi të gjitha, një zjarr i gjallë.
- ... ai ka mahnitur një publik të tërë.
- Mbas shfaqjes, populli e futi atë në zemër.

Aleksandër Moisiu, aktori i madh me origjinë shqiptare, ishte i fundit nga plejada e tragjedianëve gjigandë që shkëlqyen në artin skenik në dekadat e para të shekullit të 20-të. Ai korri triumfe të panumërta në skenat e Evropës dhe të kontinenteve të tjerë, që nga Londra në Rio de Janeiro, nga Moska në Çikago, nga Budapesti dhe Kairo, Parisi dhe Meksiko, Stokholmi dhe Milano. Shkëlqeu në horizontin e artit skenik botëror si një yll verbues, që me forcën e interpretimit të përsosur dhe zërin magjepsës, bënte të dridheshin zemrat e njerëzve. Ai e bëri veten të pavdekshëm.

Miliona njerëz që e panë në skenat e botës, kritikët më në zë apo dramaturgë të shquar, regjisorë të mëdhenj si Stanislavski e Reinhard, shkrimtarë të dëgjuar si bashkatdhetari i tij akademik Viktor Eftimiu, S. Cvaig, T. Mann, F. Molnar e shumë të tjerë - të gjithë këta njohës të shquar të artit skenik, ishin të një mendjeje në vlerësimin e Moisiut. Dhjetëra e dhjetëra vepra e monografi, mijëra artikuj studimi dhe komente, mijëra fotografi në role dhe interpretime të ndryshme, përbëjnë fondin bibliografik të Moisiut, më i pasuri dhe më i shumëllojshmi që ndodhet në arkivat shtetërore teatrale të kryeqyteteve të Evropës Qendrore si dhe të të gjithë Evropës.

Interpretimi i shkëlqyer i Faustit, Hamletit, Jederalmanit, Duedatit dhe, veçanërisht, i Fedias, bënë që emri i tij të përhapej si stuhi në vende të ndryshme të kontinenteve.

Duke filluar nga viti 1911 e deri në fund të jetës së tij, Moisiu nisi shtegtimet emocionante, duke debutuar plot triumf në skenat e qyteteve më të mëdha të botës.

E ndërpreu përkohësisht këtë krijimtari Lufta e Parë Botërore. Vitet e Luftës së Parë Botërore ishin të rëndësishme për Moisiun. Ai u rekrutua ushtar i thjeshtë dhe më vonë shërbeu si aviator në frontin gjermano-francez. Gjatë operacioneve vëzhguese, avioni i tij u dëmtua dhe ai ra në territoret e prapavijave franceze dhe u trajtua si rob lufte. «Kur ai shkoi në luftë - kujton në nga motrat e tij, Sofia, - mamaja ishte mjaft e shqetësuar dhe e zemëruar me të. Ajo i shkroi atij letra me qortime të shumta, ku i thoshte se, në qoftë se rikthehej, do ta shantë rëndë: Djal i keq! Por kur ai u kthye me të vërtetë, dhe i dukeshin qartë vuajtjet e luftës dhe të robërisë në kampet e luftës, atëherë mamaja nuk i tha asnjë fjalë. Ajo qau dhe zemra na u shtang

duke e parë atë në një gjendje të tillë të mjeruar».

Lufta e Parë Botërore imperia- liste i bëri përshtypje mjaft të rëndë Moisiut. «Lufta ndryshoi dhe deformoi çdo gjë, - thoshte ai në një bisedë me miqtë e tij. - Nuk është aspak e vërtetë që lufta ishte e nevojshme».


Nga kushtet e vështira të kampeve të përqendrimit, si rob lufte, Moisiu mundi të shpëtojë në sajë të ndërhyrjes së miqve të tij, në radhë të parë të Viktor Eftimiu, bashkatdhetarit dhe mikut të tij të ngushtë.

«Në vitin 1915, - shkruan Viktor Eftimiu, - kur ndodhesha në Berlin... erdhi tek unë aktorja Johana Terwin, gruaja e ardhshme e Moisiut. Më tha se Aleksandri ishte rob lufte në Francë, i sëmurë, dhe se, po të mbetej akoma për një kohë të gjatë në kampet e përqendrimit, ishte rrezik të vdiste... Me t'u kthyer në Bukuresht, ndërhyra pranë Ambasades së Francës dhe me gjithë mend ja arrita qëllimit: aktori i madh u lirua, duke u shkëmbyer me një gjeneral francez, i kapur prej gjermanëve. Por Moisiu s'kishte të drejtë të kthehej në Gjermani. Jetoj dhe luajtë në Zvicër deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore».

Gazeta «Flamuri i Shqipërisë», që botohej në Kostancë të Rumanisë, në numrin e 1 gushtit të 1916 i bënte jehonë çlirimit të A. Moisiut nëpërmjet përpjekjeve dhe shkrimeve që Viktor Eftimiu u kish drejtuar organeve të shtypit. «U thashë, se përveç admirimit tim për Moisiun, ajo që më shtyri të përpiqesha tutje - t'ëhu ishte edhe fakti se ai ishte shqiptar prej origjine. Ai ishte prej Durrësi, unë jam prej një vendi në afërsi të Korçës, jemi që të dy shqiptarë».

Mbas mbarimit të luftës, i ftuar nga Viktor Eftimiu, i cili në këtë kohë ishte drejtor i përgjithshëm i teatrove rumune, Moisiu shkoi në Rumaninë së bashku me Terwinin dhe grupin e tij teatral, i pritur me dashuri dhe përzemërsi nga miqtë e tij shqiptarë.

Pas luftës ai luajti me madhësi në amfiteatrot antike të Athinës, në sheshet e mëdha përpara katedraleve të Salsburgut dhe të Milanos, në arenat gjigande të cirqeve të Berlinit dhe të Vienës, në sallat e mëdha të «Gloub Thietër» të Londrës, «Sençeri thietër» të Nju Jorkut, në MHAT - teatrin artistik të Moskës etj., duke marrë nga publiku i vendeve të ndryshme të botës admirimin e



Aleksandër Moisiu (Botohet për herë të parë)

pafund dhe njëheri, kurorën e lavdisë si artisti më i madh i epokës së tij. Në miliona spektatorë të Berlinit, Parisit, Moskës, Bernës, Budapestit, Çikagos, Bukureshtit, Londrës, Stokholmit, Meksikos, Pragës, Nju Jorkut, Kairo, Tokios e Stambollit, ai la mbresa të pashyeshme, i brohoritur plot entuziazëm dhe emocion.

Gjatë dy dekadave të fundit të jetës së tij ai ishte në turne: në dhjetor 1913 - në Pragë, në nëntor 1921 - në Suedi e Rumania, në janar 1922 - në Zvicër e Rumania, në shkurt 1923 - në Hollandë, në shkurt 1924 - në Budapest e në Ballkan, në mars 1924 - në Bashkimin Sovjetik, në prill 1925 - në Budapest, në shtator 1925 - në Zvicër dhe Suedi, në dhjetor 1926 - në Zvicër, në tetor 1927 - në Paris, në nëntor 1927 - në Nju Jork, në dhjetor 1928 në Çikago, më 1929 (turne më i madh) - në SHBA, në maj 1930 - në Londër, në nëntor 1930 - në Egjipt, në janar 1931 - në Zvicër, në prill 1931 - në Argjeitinë, në dhjetor 1931 - në Meksikë, në shtator 1932 - në Stokholmi, në janar 1933 - në Hollandë, në korrik 1933 - në Milano, në gusht 1933 - në Romë, në nëntor 1933 - në Hollandë dhe Çekosllovakia, në vitin 1934 dhe 1935 - në Itali.

Në këto turne ai luajti shumë role: Hamletin, Otellon, Osvaldin, Fedian, Edipin, Duedatin, Kontin Karole, Oberonin, Jederalmanin, Idiotin, Tasson, Atorin, Faustin, Markiz Pozën, Ekdalin.

Të shkëlqyera ishin shfaqjet e Moisiut në skenat e Anglisë gjatë turneut të vitit 1930. Në sallën e «Gloub Thietër» në Londër, Glasgow, Birmingham etj. Moisiu interpretoi rolet e Fedias («Kufoma e gjallë») dhe Hamletit. Kronikat e shtypit të atëhershëm u bënë një jehonë të madhe këtyre shfaqjeve, veçanërisht artit të pakrahueshëm të Moisiut. Gazeta «Delli Telegraf» botoi një artikull të madh, ku ndër të tjera thuhej: «Z. Moisiu, më i famshmi

në aktorët modernë të Gjermanisë, i) u shfaq me një tekst gjermanisht të Tolstojt «Kufoma e gjallë». Z. Aleksandër Moisiu është një nga të pakët aktorë madhështorë që kemi pasur fatin të shohim... Menjëherë ju mësoni, pastaj nuk ju hiqet kurrë nga mendja, se keni qenë në praninë e një inteligjenti sympretë, zëri i lakmueshëm dhe i sjellshëm i të cilit, ashtu si edhe fytyra e tij, nuk është thjesht mjet shprehës. Dhe, gradualisht, ju kuptoni se këto veti, kaq të pasforcuara dhe ende aq të pagabuara, formojnë një nga personalitetet më të forta, më interesante dhe më tërheqëse, të cilit ju dorëzua çdo teatër».

«Z. A. Moisiu, - shkruante «Dhë Tajms», - mund të përvijojë një portret në ato tipare që duken si të pakapshme, ndërsa dallon në mënyrë delikate dhe të vërtetë, rridis elementeve të ndryshëm e të shumëllojshëm të punës së tij, se ai është në gjendje t'i bashkojë ato në një pikturë të vërtetë e mahnitëse».

Në artikullin «Zë mjeshtri», gazeta e Glasgow shkruante: «Megjithëse «Kufoma e gjallë» e L. Tolstojt është paraqitur në gjermanisht, është një gjë e mrekullueshme të dëgjosh A. Moisiun në këtë shfaqje... Është një zë magjepsës, një zë i fuqishëm, i mrekullueshëm dhe i përthyeshëm me një kuptim të madh dhe të gjerë».

«Zoti Moisi, - shkruante «Mançester Gardian», - vetë do të luajë një pjesë të një cilësie më të përmabjurt javën tjetër, kur ai do të na japë «Hamletin». Nderkaq, ai ka mahnitur një publik të tërë».

Në atdheun e Shekspir, ishte krejt e natyrisht që publiku të priste me interes të madh «Hamletin», në interpretimin e të cilit ai kishte parë shumë artistë të talentuar dhe që tani i jepej rasti të bënte krahasime.

«Për vetë anglezët, - shkruante gazeta «Pester Llojd» - shfaqja e

(vijon në f. 13)

(vijon nga f. 12)

Hamletit ishte, natyrisht, ngjarja më me rëndësi. Me interes dhe me syrin kritik ata ndiqnin çdo fjalë dhe veprim të Moisiut në këtë rol, që ishte për ta kaq i afërt sa asnjë tjetër. Dhe kur, më vonë, u pa në shtypin londinez se kjo shfaqje e parë e «Hamletit» në Angli në gjuhën gjermane ishte «më e mira që ishte parë në Angli qysh prej vitesh», atëherë ne besojmë se është vështirë të korrësh një lavdërim më të madh se ky.⁵⁾

«I mirënjohuri Moisi me grupin e tij, - shkruante po kjo gazetë, - ka pasur këtu një sukses të madh. Duartrokitjet kanë qenë nga çdo pikëpamje të shkëlqyeshme dhe ai e ka nderuar artin teatral me shfaqjen e dy pjesëve. Shfaqja përsëri e «Kufomës së gjallë» ka qenë realiste dhe bindëse sa që edhe njerëz, si redaktori i këtij reportazhi, që këtë pjesë e ka parë shpeshherë në Moskë, në Teatrin Artistik, e ndjenin veten të magjepsur rish-tazi. Inskeniimi u bë sipas traditave të njohura të Reinhardit dhe iu përshtat, në mënyrë të goditur, korrektorit të pjesës... Mbi të gjitha dhe mbi të tërë spikaste Aleksandër Moisiu. Ai, në rolin e Fedias, ishte më rus se sa mund të ishte ndonjëherë një rus.»⁶⁾

Triumfal ishte turneu i Moisiut në SHBA, në vitin 1927, ku ai ndërpretoi rolet e Fedias, Hamletit, Oberonit.

«Thirrje të forta dhe duartrokitje të pareshtura kumbuan mbrëmë në «Sençeri thietër»... Aleksandër Moisiu... mori duartrokitjet nga një publik i ngritur në këmbë, i rrëmbyer nga arti i tij i mrekullueshëm. Aleksandër Moisiu ishte i shkëlqyer!»⁷⁾

«Fjala përfundimtare në lidhje me Moisiun, - shkruante kritiku amerikan Luis Untermejer, - është se ai është një triumf i virtuo-zitetit. Bota e ka parë Reinhardin si krijuer të spektakleve madhështore. Pasi zbuloi mrekullinë e Moisiut, ai e dërgoi atë në skenat e botës, duke qenë i bindur se aktorët dhe kritikët do të kenë një simbol të ri dhe të lartë drejt të cilit duhet të synojnë.»

Dramaturgu i njohur Gerhard Hauptman, shkruan ndërmjet tje-rash: «Midis aktorëve të mëdhenj të Gjermanisë, personaliteti i Moisiut është i padiskutueshëm. Më shumë se kushdo tjetër, talenti i tij është i mbështetur mbi një personalitet të madh. Ashtu sikundër toni i Stradivarijusit, me të cilin lot mjeshtëri i madh Beethoven, shprehja e shpirtit të Moisiut, kur vihët në shërbim të një drame poetike, është një zë malli, dhembjeje, gëzimi dhe, mbi të gjitha, një zjarr i gjallë.»

Nga Gjeneva, ku kish parë Moisiun në skenë, Lunaçarski shkruante kështu në një artikull të botuar më 24 maj 1932 në gazetën «Veçernaja Moskva»: «Me rastin e jubileut të Gëtes, dy mjeshtër më të shquar të skenës dramatike gjermane - Aleksandër Moisiu dhe Basermani - krijuan një variant të ri skenik të pjesës së parë të «Faustit» dhe, pasi e shfaqën në shumë qytete të Gjermanisë, e paraqitën pastaj edhe në Evropë.»

Mua m'u dha rasti ta shoh në Gjenevë këtë interpretim të bukur dhe të rëndësishëm nga shumë pikëpamje të veprës së madhe të Gëtes.

...Në drejtime të shumta, në drejtimet kryesore, talenti i Moisiut, me kalimin e kohës, jo vetëm që s'po varfërohet, por është në lulëzim. Kjo s'do të thotë se Faustit i Moisiut të kënaq nga çdo pikëpamje. Si gjithmonë, Moisiu përpi-

qet ta thjeshtësojë nga paraqitja e jashtme në maksimum pamjen e heroit të tij. Sic dihet, ai kurrë nuk përdor makiazhe. Prandaj, për shembull, ai nuk dëshoi t'i kundërvinte Faustit të vjetër Faustit e përtëritur. Gjatë gjithë shfaqjes ne shikojmë përherë Moisiun, ashtu sic e njohim në jetën personale, madje edhe kostumet e tij janë modernizuar pa e ndjerë dhe nuk na langojnë aspak nga Moisiu, bashkëkohësi ynë. ...Roli i Faustit është një nga krijimet më të mëdha të Moisiut. Duke qenë përgjithësisht një recitues (deklamator) i madh, dhe, ndoshta, më i madhi i ditëve tona, ai e lexon veçantërisht në mënyrë manifestive Gëten. Qysh në fjalitë e para të Faustit, juve u pushton plotësisht timbri i mrekullueshëm i zërit, njëfarë shqiptimi i butë, i çdo fja-

norët e tij. Shfaqja u bë një ngjarje e veçantë për të parë Moisiun në kulmin e karrierës së tij.»

Gazeta «Noje Frei Presse» shkruante për shfaqjen e kësaj pjesë: «Filloi para orës dhjetë të mbrëmjes. Pesë minuta para fillimit besohej se këtu do të tregonte shumanshmërinë e tij një aktor gjerman dhe se do të guxonte të bënte një eksperiment të vështirë, të luante befasi italisht mbas një aktiviteti 30-vjeçar në gjuhën gjermane. Pesë minuta pas fillimit të shfaqjes së pritur me tension të madh, pamja ndryshoi thelbësisht... Aleksandër Moisiu erdhi dhe fitoi. Publiku italian, i entuziazmuar nga bukuria e gjuhës së tij, e brohoriti në skenë të hapët dhe ai u bë me të vërtetë, sic e kishin shpallur në pllakatat, një yll...
...Në mbarim duartrokitjet u



Moisiu në rolin e Hamletit.

le. Përpunimi i hollësishtëm, kuptimi i gjithë asaj që shqiptohet, pastaj në mënyrë të veçantë pasuria e pakrahasueshme e ngjyrave të zërit, shoqërohet gjithmonë edhe me xhestet gracioze dhe plot kuptim... Faustit i Moisiut është jashtëzakonisht simpatik. Ai të mahnit me një forcë ngadhënjese. Në momentet kur bie në mendime ose kur është dëshpëruar, në momentet e hoveve shpirtërore, erotikës, ai gjithmonë e pa ndërprerje është një njeri i mprehtë, është një njeri i shkallës së parë përsa i përket «pasurisë shpirtërore». Nga natyra e tij, Faustit i Moisiut është një figurë e paharrueshme.»

Vitet e fundit të jetës së tij, pothuaj shumicën e kohës, Moisiu e kaloi në turnetë e Italisë, ku emocionio publikun me pjesët teatrale «Hamletit», «Kufoma e gjallë» «Jederman» etj.

Gazeta «Noje Viener Zhurnal» në artikullin me titull «Shfaqja e parë e Moisiut në «Legjenda e Cilidto» - sukses sensacional» shkruante:

«Debuti i Moisiut u bë një sukses sensacional dhe e tronditi publikun. Shpërthimi i duartrokitjeve gjëmoi dhe, nga fundi, u rrit në një demonstratë... Moisiu e pushtoi menjëherë publikun dhe ajo që ka rëndësi është se nuk tërhoqi vetëm publikun, por edhe bashkëpu-

shndërruan në ovacione gjëmuese, që zgjatën mbi një çerek ore. Ishte një pamje prekëse. Moisiu në dritën e reflektorëve, shumë i lodhur, i zbetë, i lumtur, me një buzëqeshje të trishtuar, që nga e qara nuk ishte më larg nga buza që qeshte, nga sytë që shkëlqenin nga lotët. Ja, tek qëndronte një aktor i madh dhe i famshëm, i cili në kulmin e karrierës së tij pesëdhjetëvjeçare, filloi përsëri, si një njëzetvjeçar, një karrierë të re... Gjatë shfaqjes, Moisiu e ka tronditur publikun me paraqitjen e vuajtjeve njerëzore. Mbas shfaqjes, populli e futi njeriun, që vuante, në zemër.»

«Moisiu, - shkruante Ferenc Molnar, - ishte një zog shtegtar, i cili, me temperamentin e nxehtë të këngëtarëve, me poezinë e ëmbël të kujdesshme të jugut, shkon drejt veriut, gjithmonë në shtegtim, gjithmonë në fluturim, gjithmonë në rrugë... Zogu shtegtar më i dashuri e më bujari i historisë së teatrit në ditët tona.»

Gjatë gjithë jetës së tij krijuese, në shkrime dhe deklarata publike, në takime të ndryshme, kudo që ndodhej, Aleksandër Moisiu theksonte me krenari prejardhjen e vet shqiptare. Dashurinë për At-

dheun, për Shqipërinë, ndjenjën kombëtare, aspiratën e madhe për të parë Shqipërinë të përpunuar, ai e manifestonte plot mall e zjarr Shumëkush, kur ai u ngrit në pjesë destalin e skenës botërore, u për- poq ta bënte të vetin, artist italian apo gjerman.

Aleksandër Moisiu kishte Atdheun dhe Atdheun i tij ishte Shqipëria. Kujtimi i dashur i Atdheut të largët e ndoqi atë gjatë gjithë shtet- gtimeve të jetës së tij.

Më 1917 në një intervistë shtypur ai tha:

«Babai im rrjedh nga një fami- lje shqiptare, një pjesë e së cilës ende sot vazhdon të jetojë në Shqipëri.»

Plot mall e dashuri takohet Moisiu me bashkatdhetarët e tij kudo që shkonte. Në Vienë apo në Bukuresht, në Milano apo në Berlin, ai gjente kohë të bisedonte për zemërsisht me vëllezërit e tij shqiptarë, emallej, kujtonte vitet e fëmijërisë, diskutonte mbi problemet e artit dhe mbi gjendjen e Atdheut.

Gjatë turneut në Itali, në një bashkëbisedim me Renato Simonin, kritik italian, i cili çuditë me shpërthimet e temperamentit të Moisiut, që nuk janë as të natyrës italiane apo gjermane, Moisiu përgjigjet:

«I dashur Renato, ti vërtet më njeh mirë, por bën një gabim të vogël përsa i përket origjinës së me. Unë jam rritur në Shqipëri dhe jo në Itali. Sigurisht, këtu kam shkuar në shkollë dhe kam jetuar, por babai im është shqiptar dhe nëna ime është shqiptare nga arbëreshët. Shikon, pra, që gjaku im i përket origjinës sime dhe origjina është ajo që thotë fjalën e fundit. T'i shikosh shqiptarët në jetë duken si njerëz shumë të qetë, por gjithë ajo qetësi shndërron në fuqi luani e s'ka zot që i mban në se dikush i prek në se- der ose në të drejtën e tyre... Por, - vazhdoi më tej Moisiu, - ne s'kemi ende teatrot tona, prandaj mua më shikon këndeje.»

Në vitet '30 Moisiu pat kërkuar zyrtarisht të pajisej me pasaportë zyrtare shqiptare, bile të rikthehej në Shqipëri. Por satrapi Zog, që kurrë ndonjëherë nuk i kish vlerësuar njerëzit e artit dhe të kulturës dhe që kish lënë popullin në analfabetizëm të plotë, u soll me përcëimin e një injoranti, duke i kërkuar Moisiut të bëhej bufon i salloneve mbretërore. Moisiu, i fyer nga talljet e monarkut obskurantist e feudal, vazhdoi endjet e tij nëpër botë, duke ruajtur thellë në zemër dashurinë dhe respektin për Atdheun dhe popullin e tij.

Kështu, pra, në të gjitha skenat e vendeve të ndryshme, Moisiu u ngrit si një vigan në botën e brendshme të ndjenjave, zemrave, mendimeve dhe vetëdijës së njerëzve, duke e bërë veten të pavdekshëm.

1. Në mjaft gazeta evropiane të asaj kohe flitej për Moisiun si aktor gjerman, pa cilësuar origjinën e tij shqiptare, që në atë kohë e njihnin pak.
2. «Daily Telegraph», Londër; 25.5.1930.
3. «The Times», Londër, 27.5.1930.
4. «Glasgow Evening Times», 27.5.1930.
5. «Pester Lloyd», 8.6.1930.
6. Idem.
7. New York Evenry Journal; 28.11.1927.
8. «Neues Viener Journal»; 12.7.1933.